

AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË PRIVATE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"PIRRO" SH P K TIRANË.

Në Tiranë, sot me datë 2.2.1995, unë i nënshkruari Spiro Ruço, i biri i Petros, datlindja 1959, lindur në Ersekë, banues në Tiranë, rruga Gjin Bue Shpata Nr 5, me cilësinë e ortakut të vetëm, me vullnetin tim të lirë e të plotë vendosa të krijoj shoqërisë private "Pirro" SH P K Tiranë.

H Y R J E

Në kuptim të këtij akti themelues, ortakut i vetëm Spiro Petro Ruço, është themeluesi i shoqërisë private "Pirro" SHPK.

Qëllimi i këtij akti themelues është krijimi i shoqërisë private "Pirro" SHPK me qendër në Tiranë, rruga Gjin Bue Shpata Nr 5 dhe shtrirja në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj.

Shoqëria private "Pirro" SHPK rregullon veprimtarinë e saj në përputhje me aktin e themelimit, statutin e saj, me ligjin 75I2, datë 7.4.1992 si dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore të miratuara për këtë qëllim.

O B J E K T I

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë private "Pirro" SHPK do të jetë:

Import-Eksport, përpunime argjendi e ari, si unaza, varse, medaljone, zinxhirë, vathë etj.

A F A T I V E P R I M T A R I S

Veprimtaria e shoqërisë do të jetë efektive nga data e rregjistrimit në rregjistrin tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë si dhe me paisjen me lejen përkatëse nga organet kompetente.

Shoqëria do të veprojë me një afat mbi 10 vjet me të

drejtë shkurtimi të afatit ose të zgjatjes së tij.

K A P I T A L I

Kapitali themelor i shoqërisë private "Pirro" SHPK përbëhet nga kontributi fillestar i ortakut të vetëm themelues Spiro Ruço i cili arrin në vlerën 100 mijë lek të reja.

Ortaku i vetëm themelues ka të drejtë që me nxjerrje të bilanceve periodike ose vjetore të përfitojë përqindjet e realizuara nga veprimtaria private.

Shoqëria mban përgjegjësi për të gjitha detyrimet shtetërore, sigurimet shoqërore etj.

J U R I D I K S I O N I

Shoqëria private "Pirro" SHPK e ka qendren e saj në Tiranë, rruga Gjin Bue Shpata Nr 5.

Të gjitha mosmarëveshjet me persona juridikë vendas e të huaj si dhe organet shtetërore zgjidhen me mirëkuptim, ose në të kundërt zgjidhja e tyre mund të bëhet në Gjykatën e Rrethit Tiranë.

THEMELUESI I SHOQËRISË

(Spiro Petro Ruço)

Spiro Ruço

S T A T U T

I

SHOQËRISË PRIVATE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"PIRRO" SH P K .

Shoqëria private "Pirro" SHPK është krijuar në bazë të Aktit të themelimit nga ortaku i vetëm Spiro Petro Ruço për veprimtari Import-Eksporti si dhe shërbime të përmendura në objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

Ortaku i vetëm, Spiro Ruço, me vullnetin e tij të lirë të plotë, në bazë të ligjit 7638ndatë 19.II.1992 "Për shoqëritë tregtare" u muar vesh të hartojë këtë statut si vijon:

K R E U I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

NENI I

EMËRTIMI, KOHËZGJATJA, LLOJI, OBJEKTI.

Shoqëria do të ketë emrin "Pirro" SH P K.

Shoqëria private "Pirro" SHPK bëhet person juridik me rregjistrimin e saj në Gjykatën e Rethit Tiranë, në rregjistrin tregtar.

NENI 2

Shoqëria "Pirro" SHPK do të ketë një kohë zgjatje pa afat por më shumë se 10 vjet dhe do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 3

Selia e shoqërisë private "Pirro" SHPK është në Tiranë, rruga Gjin Bue Shpata Nr 5.

Shoqëria ka të drejtë të hapë zyra e filiale në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj.

NENI 4

NENI 4

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë private " Pirro " SHPK është:

Import-Eksport;përpunim argjendari dhe ari,si unaza, varse,medaljone,zinxhinë,vathë etj.

KREU II

KAPITALI I SHOQËRISË

NENI 5

Kapitali themelor i shoqërisë është 100 (Njëqind) mijë lek të reja.Ky kapital është krijuar me kontributin e ortakut te vetëm,themeluesit të shoqërisë private "Pirro" SH P K .

NENI 6

Kapitali është i ndarë në 100 pjesë ku sejcila pjesë përbën një vlerë prej 1 (Një) mijë lekë

NENI 7

Ortaku i vetëm nuk ka kufizim në shtimin e kapitalit bazë.

KREU III

MBARËDHËNIET EKONOMIKO FINANCIARE

NENI 8

Për pasqyrimin e aktivitetit të shoqërisë ortakut i vetëm ose persona të autorizuar prej tij janë të detyruar të mbajnë dokumentacion të rregullt financiar dhe rregjistrat përkatës sipas ligjit të veçantë.

Neni 9

Shoqëria do të përgjigjet në afat për kontributin fiskal afatet e derdhjes së tij,sigurimet shoqërore etj.

NENI 10

NENI IO

Shoqëria ka të drejtë të hapë llogari më vehte ne Bankën e Shtetit Shqiptar si dhe jashtë vendit dhe të kryejë veprimet e likuidimit nëpërmjet tyre.

NENI II

Shoqëria është e detyruar të paraqes në afat bilanci vjetor së bashku me deklaratën e të ardhurave ,të fitimeve e të humbjeve dhe ti depozitojë ato në organin financiar të juridiksionit ku ushtr në aktivitetin e vet financiar.

Neni I2

Shoqëria ka të drejtë të vetfinancohet me valute ose me lek të huaj dhe anasjelltas duke bërë këmbime të lekut shqiptar me valutë të huaj në përputhje me kursin e caktuar nga Banka e Shtetit Shqiptar në Tregun e litë të valutës.

Neni I3

Shoqëria mund të marrë kredi në lek ose në valutë të huaj nga Banka e Shtetit Shqiptar ose nga Banka të tjera të huaja.

Gjithashtu shoqëria ka të drejtë të tarnsferojë jasht shtetit kapitatal e saj.

Neni I4

Fitimi i shoqërisë do të llogaritet nga diferencë e arkëttimeve të përfituara dhe shpenzimeve ,pagesave të kryera si dhe gjithë detyrimeve të legjislacionit të fuqi.

Neni I5

Fitimi i realizuar nga shoqëria private "Pirro" SHPK do të bëhet sipas vendimit të oratkut të vetëm.

KREU IV

KREU IV

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Neni 16

Shoqëria private me përgjegjësi të kufizuar "Pirro" drejtohet ngz ortaku i vetëm themelues i saj Spiro Ruço.

Neni 17

Administratori që është edhe ortaku i vetëm i shoqërisë ka këto të drejta e detyrime:

- Vendos për miratimin dhe ndryshimin e staturit.
 - Miraton programin ekonomik të shoqërisë.
 - Miraton lidhjet e marëdhëniet ekonomiko financiare të shoqërisë me persona juridikë e fizikë vendas e të huaj.
 - Miraton organikën e shoqërisë, të specialistëve dhe të punonjësve.
 - Përcakton pagat e punonjsve.
- Si dhe të gjithë veprimtarinë e shoqërisë së tij.

Neni 18

Administratori ka të drejtë të autorizojë me prokurë një person tjetër për të kryer veprimet në emër të shoqërisë.

KREU V

LIKUJDIMI SHOQËRISË

Neni 19

Ortaku i vetëm ka të drejtë ta mbyllë shoqërinë ose ta likujdojë atë duke tërhequr kapitalet e tij pasi të ketë plotësuar të gjitha detyrimet ndaj shtetit dhe ndaj të tretëve.

Neni 20

Për kryerjen e këtij procesi ai cakton një likujdator i cili paraqet raportin përfundimtar të likujdimit të shoqërisë.

Neni 2I

Shoqëria private me përgjegjësi të kufizuar " Pirro " ka vulën e saj.

KREU VI

ZGJIDHJA MOSMARËVESHJEVE

Mosmarëveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të aktivitetit ,kur nuk gjejnë zgjidhje me diskutim miqësor,është kompetente Gjykata e Rrethit Tiranë për zgjidhjen e tyre.

Përsa nuk është shprehur në këtë statut veprojnë dispozitat e përgjithshme të legjisllacionit në fuqi.

Statuti u përpilua në katër kopje për tju dorëzuar organeve kompetente dhe një kopje e tij qëndron në dokumentacionin e shoqërisë.

ADMINISTRATORI

ORTAKU I VETËM

SPIRO RUCO